



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Nr. 2088/1 Prot.

Tiranë, më 1.6.2020

NJOFTIM

Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, Kreu V – "*Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë*", nenit 25, "*Lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive*" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.3.2015 "*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës, dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*", i ndryshuar, Kreu VII, Njësia Përgjegjëse e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, njofton se;

Në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 2565 prot, datë 29.5.2020 pika 7, për lejimin e kryerjes së konkurseve për punësim të personelit, pas verifikimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur brenda afateve të përcaktuara dhe të pezulluara në kushtet e masave për parandalimin e COVID-19, shpall Listën e Kandidatëve, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta dhe që do të vazhdojnë konkurrimin në procedurën "*Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive*", të kategorisë ekzekutive në grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm në pozicionin, Specialist në Sektorin e Arkiv-Protokoll dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurisë në ILDKPKI, që do të rezultojnë pas përfundimit të levizjes paralele, si më poshtë;

1. Megi Tivari
2. Marçela Ruço
3. Kjara Mita
4. Selma Biçi

Konkurrimi- testimi me shkrim do të bëhet në datën 17.6.2020, në mjediset e ILDKPKI, në orën 10.00. Lista e fituesve me mbi 70 pikë (*mbi 70 % të pikëve*) do të shpallen në datën 19.6.2020.

Për sqarime mund të kontaktoni në adresën e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Rruga "*Reshit Çollaku*", Tiranë, si dhe të konsultoni faqen zyrtare në internet www.ildkpkj.al.

**ILDKPKI
NJËSIA PËRGJEGJËSE**